

Nr.29

ISSN 2521-831X

BULETINI MUJOR

KLIMATIK

Maj 2019

Universiteti Politeknik i Tiranës


Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit



Tirana © 2019

Dielli

Pamje e mësipërme e datës 31 maj 2019 tregon Diellin pa asnjë njollë në të. Dielli gjatë periudhës **korrik 2019 - shtator 2020**, pjesë e ecurisë së ciklit të 24, pritet të ndodhet në minimumin e numrit të njollave diellore, siç kjo paraqitet dhe në grafikun në të djathtë.





BULETINI MUJOR KLIMATIK

Maj 2019

Nr.29

Përmbledhje. Muaji maj 2019 vijoi në ngjashmëri me muajin prill dhe u karakterizua kryesisht me vranësira dhe reshje. Temperaturat e ajrit shënuan vlera më të ulta se ato të normës me rreth -1.1°C . Ndërkohë, reshjet shënuan vlera mjaft më të larta se norma me afro 173%, ndërkohë numri i ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm shënoi vlera 165% përkundrejt vlerave mesatare shumëvjeçare. Nuk mungoi dhe prezenca e pluhurit me origjinë nga Saharaja gjatë disa ditëve të muajit maj. Në kontekstin e ndryshimeve klimatike jepet një shpjegim edhe për "anomalinë" e temperaturave për kryeqytetin që është e ndryshme nga pjesa tjetër e vendit. Vlerësimet mbi situatën e pritshme meteorologjike në muajt në vijim së bashku me një informacion mbi publikimin e këtij buletini në "web site" e WMO, etj., përmbyllin këtë buletin.

Summary. The month of May 2019 resembled April and was characterized mainly by clouds and rainfall. Air temperatures marked lower than those of the norm at around -1.1°C . Meanwhile, rainfall marked quite higher values than the rate of about 173%, while the number of days with precipitation over the 1.0 mm threshold marked the value of 165% versus average multiannual values. There was also the presence of dust originating from Sahara during several days of May. In the context of climate change there is also an explanation for the "anomaly" of temperatures for the capital that is different from the rest of the country. Estimates of the expected meteorological situation in the coming months along with information on the publication of this bulletin on the WMO web site, etc., conclude this bulletin.

SITUATA SINOPTIKE

Ngjarja e parë e muajit ishte një re pluhuri nga Saharaja në datat 4-5 në sasi të larta në Jug dhe më të pakta në Veri dhe në Qendër të vendit.



Njëkohësisht pati edhe reshje mesatare, deri intensive në pothuajse gjysmën e qarqeve. Lokalisht ato ishin "intensive" deri "shumë intensive", ku shkaku kryesor ishte një front i ftohtë.

Në datën 5 në vendmatjen meteorologjike të Vlorës u regjistruan 79 mm shi në vetëm 6 orë (ora 06÷12 UTC) dhe 112mm / 24h (sipas SHMU, OgiMet). Ndërsa në Tiranë u regjistruan rreth 30 mm deri në ora 10 të datës 5.

Gjithashtu një ditë më pas, në datën 6, atmosfera mbeti e paqëndrueshme dhe në zonën e Shkodrës pati disa stuhi, shoqëruar edhe me breshër, sipas mesazhit SYNOP të SHMU, ora 15 UTC (ora 17 lokale). Shkak ishte një masë ajrore e ftohtë për muajin maj (me origjinë nga Arktiku), e cila mbërriti në detin Mesdhe nëpërmjet një lugine valë-gjatë të krijuar në sipërfaqen 500 hPa.

Ana jugore e saj formoi një “cut-off low” në detin Adriatik dhe një baroklinicitet të fortë në Mesdheun Qendror dhe krijoi një “jet-stream” me shpejtësi të erës deri në 40÷45 m/s në nivelin 500 hPa. Ky “cut-off low” më vonë kaloi mbi gadishullin e Ballkanit, siç mund të shihet në figurën e mëposhtme Nr.1:

Figura Nr.1. – Pamja nga situata sinoptike e datës 6 maj 2019.




Në fund të datës 9 dhe në fillim të datës 10 një “okluzion”, i pasuar nga një front i ftohtë i dobësuar solli reshje intensive.

Figura Nr.2. – Pamja nga situata sinoptike e datës 10 maj 2019.

Në datat 26 deri 28, u evidentua një tjetër transport pluhuri nga Saharaja, por i ndjeshëm edhe në datën 27, me vlera afër mesatares, siç shihet në hartën e mëposhtme, në figurën Nr. 3.

Në datën 27 pasdite situata ka qenë shumë konvektive, madje vrojtuesi i SHMU-së në Tiranë raportoi edhe breshër, pasi më parë kishte raportuar 3 herë stuhi, siç e tregojnë edhe vrojtimet mëposhtme.

Figura Nr. 3. – Vlerësimi i bërë nga Qendra e Parashikimit të Pluhurit në Barcelonë më datë 25 maj 2019, për dy ditët në vijim.



Latitude: 41-20N Longitude: 019-48E Altitude: 90 m.																
Decoded synop data. (07:19 mean solar time)																
Time interval: 2 days before 2019/05/28 at 06:00 UTC.																
Date	T (C)	Td (C)	Tmax (C)	Tmin (C)	ddd	ff kmh	P0 hPa	P sea hPa	P Tnd	Prec (mm)	NN t h	NN H Km	Vis km	WW	W1	W2
05/28/2019 06:00	18.8	16.4	----	16.0	E	3.7	996.0	1005.7	+0.3	7.0/12h	2 1	1.0	15.0	☁	☁	☁
05/28/2019 03:00	16.8	16.8	----	----	CAL	0.0	996.3	1006.0	-0.6	----	3 3	0.6	10.0	☁	☁	☁
05/28/2019 00:00	17.4	17.4	----	----	CAL	0.0	996.8	1006.6	-1.1	7.0/6h	5 3	0.6	10.0	☁	☁	☁
05/27/2019 21:00	19.0	19.0	----	----	NNW	3.7	998.0	1007.7	+0.4	----	8 8	0.6	75.0	☁	☁	☁
05/27/2019 18:00	22.0	15.8	29.4	----	NW	3.7	997.6	1007.2	+0.1	0.2/12h	7 7	0.6	10.0	☁	☁	☁
05/27/2019 15:00	25.4	14.9	----	----	W	3.7	997.5	1007.0	+0.1	----	7 7	0.6	10.0	☁	☁	☁
05/27/2019 12:00	27.6	12.0	----	----	SSE	3.7	997.6	1007.0	-1.7	0.2/6h	4 4	---	15.0	☁	☁	☁
05/27/2019 09:00	21.8	12.5	----	----	SSE	7.4	999.3	1008.9	+0.3	----	8 4	1.0	15.0	☁	☁	☁
05/27/2019 06:00	17.6	16.8	----	17.0	CAL	0.0	999.6	1009.3	+0.5	8.0/12h	8 3	1.0	10.0	☁	☁	☁
05/27/2019 03:00	19.0	19.0	----	----	CAL	0.0	1000.0	1009.7	+0.0	----	8 8	0.6	10.0	☁	☁	☁
05/27/2019 00:00	19.8	19.4	----	----	CAL	0.0	1000.0	1009.7	-0.8	Tr/6h	7 4	1.0	10.0	☁	☁	☁
05/26/2019 21:00	20.2	19.2	----	----	CAL	0.0	1000.8	1010.5	+0.0	----	7 2	1.0	10.0	☁	☁	☁
05/26/2019 18:00	21.6	18.1	24.4	----	W	7.4	1000.8	1010.4	+0.4	0.0/12h	8 2	1.0	10.0	☁	☁	☁
05/26/2019 15:00	21.6	17.4	----	----	W	3.7	1001.2	1010.8	-0.7	----	7 3	1.0	10.0	☁	☁	☁
05/26/2019 12:00	23.4	13.6	----	----	NW	11.1	1001.9	1011.5	+0.1	0.0/6h	8 2	1.0	15.0	☁	☁	☁
05/26/2019 09:00	23.8	14.0	----	----	W	3.7	1002.0	1011.6	+0.2	----	8 3	1.0	15.0	☁	☁	☁
05/26/2019 06:00	19.0	13.6	----	15.2	SE	3.7	1002.1	1011.9	+0.0	0.0/12h	8 6	1.0	15.0	☁	☁	☁

Figura Nr. 4.- Pamje nga të dhënat operative të marra nga vendmatjet meteorologjike referuar datës 27 maj 2019 për natyrën dhe intensitetin e reshjeve.

Pluviometri në godinën e IGJEUM regjistroi 9 mm shi në 8 minuta, shih grafikun e mëposhtëm në figurën Nr.5. Këtë moment kohor e konfirmuan edhe dy stacione automatike individuale, por në vlera pak më të ndryshme: ai i ndodhur në rrugën “Rr. Sami Frashëri” shënoi 9.0mm /16 min. ndërsa ai tek “Ura e Tabakëve” me 9.4mm / 50min.




Figura Nr. 5.- Pamje nga ecuria progresive e reshjeve të marra nga vendmatja meteorologjike referuar datës 27 maj 2019 në IGJEUM.

Informacione më të detajuara mbi reshjet dhe temperaturat e ajrit jepen në vijim, bazuar në të dhënat e vendmatjeve meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik për zonat dhe nën zonat e ndryshme klimatike të vendit tonë.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE METEOROLOGJIKE TË MUAJIT: MAJ 2019 DHE DISA KONSIDERATA MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE

DIELLËZIMI - Treguesi i diellëzimit (numrit të orëve me diell) për muajin maj 2019 në shkallë vendi ashtu si dhe në muajin e mëparshëm shënoi vlera më të ulta se norma për shkak të pranisë së vranësirave dhe reshjeve mbi normë. Në vendmatjen meteorologjike të Pogradecit (figurë Nr.6) u vrojtuan 188 orë, vlerë rreth 25.2% më e ulët se norma. Në Përmet u shënuan 180 orë, ndërsa në Xarë (e karakterizuar me më pak vranësira e reshje) u shënuan 290.5 orë me diell.




Figura Nr.6. – Vlerat e treguesit të orëve me diell, sipas normës, për vitin 2018 si dhe deri në muajin maj për vitin 2019 për Pogradecin.

TEMPERATURAT E AJRIT – Muaji maj 2019 u dominua nga prania e masave ajrore relativisht të freskëta, të cilat mbizotëruan në pjesën më të madhe të kohës mbi territorin e vendit tonë, duke shënuar vlera më të ulta se ato të normës me rreth -1.1°C . Në figurën Nr.7 dhe Nr.9/1÷9/12 paraqiten të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit të përzgjedhura për disa vendmatje meteorologjike nga zonat dhe nënzonat e ndryshme klimatike të vendit tonë.




Figura Nr.7. – Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për muajin maj 2019 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës (1961÷1990).

Një informacion mbi vlerat përkatëse të muajit maj 2019 si për temperaturat mesatare ashtu dhe anomalitë në shkallë kontinentale jepet në vijim në figurën Nr. 8 dhe Nr. 10.


















Figura Nr.8. – Vlerat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin maj 2019 për kontinentin European dhe anomalitë përkatëse ndaj periudhës shumëvjeçare 1981÷2010, sipas NOAA-s.

Vlerësime për ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet (figurat në vijim Nr.9/1÷9/12) në disa prej vendmatjeve meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik për muajin: Maj 2019.





Temperaturat maksimale të ajrit gjatë muajit maj 2019 shënuan një shmangie negative kundrejt vlerave të normës, e cila arriti deri në rreth -1.1°C . Paraqitja grafike e vlerave mesatare të temperaturave maksimale për disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë është dhënë në figurën Nr.12, ndërsa vlerat ekstreme maksimale në shkallë kontinentale paraqiten në figurën Nr.11. Temperaturat maksimale gjithsesi duhet thënë ruajtën vlera të moderuara duke mos shënuar ekstremitete në shkallë kontinentale, ndërsa në raport dhe me vlerat minimale përgjithësisht ndikuan në vlera amplitude të luhatura në nivele më të ulta.



Vlerat e temperaturave maksimale absolute mujore të ajrit të vërtetuara gjatë muajit maj 2019 në territorin e Shqipërisë janë paraqitur në figurën Nr.13. Në pak raste ato kaluan mbi pragu 30°C.




Figura Nr.12. – Vlerat mesatare të temperaturës maksimale të ajrit për muajin maj 2019 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.




Figura Nr.13. - Vlerat e temperaturave maksimale absolute të ajrit për muajin maj 2019 për disa vendmatje meteorologjike në vendin tonë.

Temperaturat minimale të ajrit për muajin maj 2019 shënuan një rënie përkundrejt vlerave të normës me -1.1°C . Paraqitja më e detajuar për vlerat minimale ekstreme të temperaturave minimale të ajrit për javët përkatëse të muajit maj 2019 në shkallë kontinentale jepen në figurën Nr.16, ndërsa për vendin tonë vlerat mesatare minimale dhe minimale absolute paraqiten në figurën Nr.14 dhe Nr.15.




Figura Nr.14. -Vlerat mesatare të temperaturës minimale të ajrit për muajin maj 2019 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.





Figura Nr.15. - Vlerat e temperaturave minimale absolute të ajrit për muajin maj 2019 për disa vendmatje meteorologjike në vendin tonë.



Mungesa e ngricave të vonshme të pranverës ishte pozitive për mjaft kultura bujqësore, të cilat shpesh herë në këtë periudhë kohore pësojnë dëme nga kjo dukuri.

RESHJET ATMOSFERIKE

Muaji maj 2019 u shoqërua me një numër të lartë të ditëve me reshje, ndërsa vlera totale e tyre kaloi paksa mbi vlerat e normës. Reshjet e vrojtuar në formë shiu arritën deri në +73.4% kundrejt vlerave të normës. Të dhënat në fjalë në mënyrë grafike për 44 vendmatjet meteorologjike të analizuar paraqiten në figurën Nr.17.




Figura Nr.17. - Vlerat e sasisë së reshjeve për muajin maj 2019 për disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë si dhe vlerat përkatëse të normave referuar periudhës mesatare shumëvjeçare 1961÷1990.

Situata dominuese me vranësira dhe reshje gjatë muajit maj 2019 dukshëm evidentohet dhe nga parashikimet ditore të motit. Gjatë këtij muaji me përjashtime të pakta në territorin e vendit pjesërisht apo tërësisht në shkallë vendi, në shumicën e ditëve evidentohen mundësitë për reshje, siç kjo paraqitet dhe në figurën Nr.18.

Treguesi i numrit të ditëve me reshje mbi pragu 1.0 mm i paraqitur në figurën Nr.19, për muajin maj 2019 evidenton vlera mbi normë, me rreth +65.1% të normës ose rreth 5.2 ditë më shumë.




Figura Nr.18. Parashikimet për reshjet e pritshme 24 orëshe për çdo ditë gjatë muajit maj 2019.




Figura Nr.19. – Vlerat e treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi pragu 1.0 mm për muajin maj 2019 për disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë si dhe vlerat e normës 1961÷1990.

Reshjet e muajit maj 2019 në shkallë kontinentale paraqiten në figurën në vijim Nr.20 (A), ku siç shihet një pjesë e hapësirës së vendit tonë për këtë muaj dallon lehtësisht për anomali pozitive (B), përkundrejt periudhës shumëvjeçare 1981÷2010.




Figura Nr.20. - Reshjet për muajin maj 2019 në kontinentin European dhe anomalitë kundrejt periudhës 1981÷2010, sipas NOAA-s.





Figura Nr.21. - Vlerat në përqindje kundrejt normës, të reshjeve për muajin maj 2019, për kontinentin European, sipas NOAA-s.

Përgjithësisht reshjet gjatë muajit maj 2019 ashtu si dhe në muajin e mëparshëm ishin të shtrutura dhe të vrojtuara në një numër ditësh më të madh se norma si dhe nuk shënuan intensitete të larta (shih dhe figurën Nr. 23).

Figura Nr. 22 - Reshjet (në mm) gjatë muajit maj 2019 sipas "DMCSEE, Drought Management Centre for Southeastern Europe".

Gjithsesi duhet theksuar se pjesa VP e vendit u karakterizua me reshje më të shumta, të cilat tejkaluan mjaft vlerat e normës me më shumë se dyfishin e tyre, siç kjo paraqitet me të dhëna të detajuara në tabelën Nr.1, apo në hartën me reshjet e muajit maj 2019 për Ballkanin në figurën Nr. 22. Të dhënat konkrete nga Sistemi i Kombëtar i Monitorimit Meteorologjik tregojnë dhe



një herë sa të rëndësishme janë matjet konkrete në vendmatje, përkundrejt atyre informacioneve të prodhuara nga modele të ndryshme, informacionet satelitore apo produkte të tjera të çdo natyre qofshin, të cilat kur nuk marrin në konsideratë të dhënat e vrojtuar konkretisht, ofrojnë vlerësime që mund të jenë larg realitetit, siç kjo ndodh dhe me hartën e figurën Nr. 22, ku pjesa VP e vendit tonë ka reshje me vlera mbi 300 mm (Rapsh 364.7, Dajç Bunë 338.3mm, etj.).




Figura Nr.23. - Reshjet maksimale 24 orëshe për 44 vendmatje meteorologjike të Shqipërisë për muajin maj 2019.

Nr.	Vendmatja meteorologjike	Reshje (në mm)	Nr.	Vendmatja meteorologjike	Reshje (në mm)
1	Belsh	147.4	23	Krujë	220.7
2	Bilisht	80.5	24	Kuç	186.1
3	Brataj	173.0	25	Lekbibaj	247.1
4	Çukë	72.0	26	Likmetaj	135.0
5	Dajç Bunë	338.3	27	Liqenas	79.0
6	Dajt Rez.	190.8	28	Mashtërkorë	271.0
7	Dardhë	113.0	29	Narel	271.2
8	Dushar	154.5	30	Peqin	101.5
9	Dushman	162.9	31	Petkaj	157.9
10	Fratar	108.4	32	Petrelë	173.0
11	Fshat Klos	215.0	33	Petresh	184.3
12	Gorricë e M.	108.4	34	Potom	133.2
13	Hoshtevë	144.4	35	Prenjas	104.3
14	Hot	194.0	36	Qafzëzë	50.0
15	Jaronisht	246.0	37	Qarrishtë	228.0
16	Kalimash	106.9	38	Rapsh	364.7
17	Kallmet	234.2	39	Shishtavec	127.0
18	Kardhiq	117.6	40	Shupenzë	154.5
19	Këlcyrë	84.4	41	Sinjë	134.4
20	Konispol	80.5	42	Tiranë	137.4
21	Korça	134.4	43	Topojan	148.9
22	Krahës	93.0	44	Tropojë	142.0


Tabela Nr. 1 – Të dhënat e reshjeve të vrojtuar në muajin maj 2019 në 44 vendmatje meteorologjike të vendit tonë, ose rreth 1/3 e tërësisë së vendmatjeve të SKMM.

Në këtë kontekst paraqiten grafikisht dhe të dhënat e reshjeve maksimale 24 orëshe në figurën Nr.23 për 44 vendmatje meteorologjike, të cilat gjithsesi nuk shënojnë ndonjë vlerë të re rekord në historinë e vrojtimeve meteorologjike për këtë muaj, pasi janë larg në madhësi kundrejt tyre.


Stina e pranverës dhe reshjet.

Kjo stinë nisi me një muaj mars tejte të thatë me pak reshje dhe një deficit të theksuar lagështie dhe vijoi me muajt prill dhe maj me mjaft reshje, të cilat ishin mbi normë. Gjithsesi në totalin e tyre ato nuk arritën apo ishin pranë vlerave mesatare të stinës, ku vetëm në disa hapësira të kufizuara të vendit ato shënuan madhësi lehtësisht mbi normë, siç kjo paraqitet dhe në hartën e figurës Nr.24.

Figura Nr. 24. - Përqindja kundrejt normës e reshjeve për stinën e pranverës mars - maj 2019 për kontinentin European, sipas NOAA-s.



Muaj maj 2019 ndonëse në shkallë kontinentale dhe po ashtu dhe për hapësirën e vendit tonë shënoi vlera nën normë me rreth -1.1°C , për Tiranën temperaturat e ajrit ishin paksa më të larta se norma me $+0.3^{\circ}\text{C}$. Kjo situatë në dukje “anomalie” spjegohet dhe është e lidhur me efektin e ndikimit të “Ishullit Urban”, që përgjithësisht ka përcjellë vazhdimisht për hapësirën e kryeqytetit vlera me shmangie $+1^{\circ}\text{C}$ deri $+2^{\circ}\text{C}$ më të larta, përkundrejt pjesës tjetër të territorit.




Për të patur një pamje më të plotë mbi ecurinë e temperaturave mesatare të ajrit për kryeqytetin nga janari deri në maj 2019 në figurën Nr.25 jepet paraqitja grafike e vlerave të këtij viti, ato të normës si dhe ato të periudhës 2012-2018.

Figura Nr.25. – Ecuria e temperaturave mesatare mujore sipas vlerave të normës, periudhës 2012-2018 dhe muajve janar - maj 2019.

Të dhënat e muajit maj 2019 paraqiten në figurën Nr.26, dhe i referohen për krahasim periudhës shumëvjeçare 1961÷1990 (me ngjyrë jeshile), ndërkohë që evidentohen dhe muajt maj të viteve të fundit 2012÷2018, ku qartë shihet se muaji maj i këtij viti i afrohet mjaft vlerës së normës.

Figura Nr.26. – Të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin maj për vitet 2012÷2019 dhe vlerat e normës referuar periudhës 1961÷1990 për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.



Për rëndësinë që ka klima dhe ecuria e saj muaj pas muaji nga qendrat kryesore në botë të monitorimit meteorologjik nxirren përfundime dhe vlerësime specifike për zonat me shmangie pozitive apo negative dhe mjaft deduksione të tjera që kanë të bëjnë me pritshmëritë e saj në muajt në vijim. Në figurën Nr. 27 jepet një pamje e asaj që është vërtetuar në maj 2019 në shkallë planetare, ku një pjesë e mirë e kontinentit tonë ka shënuar shmangie negative.




Figura Nr. 27. - Anomalitë e temperaturave të ajrit të matura në sipërfaqe të Tokës për muajin maj 2019 përkundrejt periudhës 1981÷2010, sipas vlerësimit nga qendrat profesionale: Copernicus, ECMWF, Climate Change Service & EU.

STUHITË

Sipas qendrës eksperimentale të monitorimit dhe parashikimit europian ESTOFEX, në kontinentin Europian gjatë muajit maj 2019 stuhitë ishin të pranishme në nivel mesatar; 9 të kategorisë së parë, 10 të kategorisë së dytë dhe asnjë e kategorisë së tretë. Më poshtë në figurën Nr.28 paraqitet numri i stuhive të kategorisë së parë për muajin maj për periudhën 2006÷2019.




Figura Nr.28. - Numri i stuhive të kategorisë së parë për muajin maj për periudhën 2006÷2019, referuar sistemit ESTOFEX.

Veçori karakteristike për muajin maj 2019 ishte se stuhitë e kategorisë së parë dhe të dytë u vrojtuan në qendër të kontinentit Europian. Për ilustrim në figurën Nr.29 paraqitet situata e datës 20 maj 2019. Në total numri i stuhive për periudhën janar ÷ maj 2019 ishte 45 për kategorinë e parë, 19 për kategorinë e dytë dhe asnjë për kategorinë e tretë. Numri i stuhive të kategorisë së dytë për muajin maj për periudhën 2006÷2019 paraqitet në figurën Nr.30.




Figura Nr.29. Situata e pritshme për stuhi të kategorive 1, 2 dhe 3 e vlerësuar më datë 19 maj 2019 në ora 18:55 UTC për dy ditët në vijim në kontinentin Europian.




Figura Nr.30. - Numri i stuhive të kategorisë 2, për muajin maj për periudhën 2006÷2019, referuar sistemit ESTOFEX.

VLERËSIMET MBI SITUATËN METEOROLOGJIKE TË PRITSHME PËR MUAJT NË VIJIM

Parashikimet meteorologjike afatmesme dhe afatgjata mbi kushtet meteorologjike të pritshme mbi hapësirën e kontinentit European dhe të Mesdheut për muajt e ardhshëm paraqiten në figurat në vijim (Nr.31÷Nr.32).

**Parashikimi i probabiliteteve për temperaturat e ajrit për muajt
Korrik - Tetor 2019 Përgatitur: QERSHOR 2019**




Figura Nr.31. - Parashikimi i probabiliteteve për temperaturat e ajrit për muajt: KORRIK– TETOR 2019.


Vlerësimet për çdo muajt përkatësisht për periudhën Korrik - Tetor 2019, të përftuara nga modelet matematikore meteorologjike evidentojnë se pritet një verë e nxehtë dhe kryesisht e thatë përsa i përket kontinentit Europian.

Por, parashikimi afatmesëm, më konkretisht në hapësirat e Mesdheut për muajin korrik paraqet anomali të theksuara përsa i përket reshjeve. Në pamjet përkatëse mbi temperaturat dhe anomali të tyre për kontinentin tonë, specifikisht për vendin tonë evidentohej se për muajin korrik do të kemi temperatura ajri të pritshme rreth normës. Por, bazuar në pamjen e parashikimit për reshjet në figurën Nr.32 në muajin korrik pjesa lindore mund të preket nga reshjet mbi normë, të parashikuara për rajonin tonë.

Kurse për tre muajt në vijim evidentohej probabilitete që anojnë për temperatura ajri të pritshme dukshëm mbi normë. Në këto vlerësime që janë rezultat i produkteve të marra nga modele profesionale shkencore merren në konsideratë dhe dukuria “El Nino” si dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në ecurinë e klimës për muajt në vijim.

Reshjet për periudhat përkatëse, të pasqyruara në figurat Nr.32, tregojnë një situatë të pritshme me thatësi të theksuar, por gjithsesi duhet evidencuar fakti se rajonet pranë vendit tonë janë të predispozura për dukurinë e thatësirave.

**Parashikimi i probabiliteteve për reshjet për muajt
Korrik - Tetor 2019 Përgatitur: QERSHOR 2019**




Probabilitetet (devijimet nga norma në mm) të kategorive më të mundshme
nën normë mbi normë



*Figura Nr.32. - Parashikimi i probabiliteteve për reshjet për muajt:
KORRIK – TETOR 2019.*



WMO RA VI - Regional Climate Centre on Climate Monitoring



“Buletini Mujor Klimatik” i Shqipërisë duke filluar nga muaji prill 2019 është pjesë e publikimeve të produkteve mujore të vendeve europiane dhe pasqyrohet dhe në faqen Web të Zonës VI të WMO / OBM (Organizatës Botërore të Meteorologjisë).

Për produktet e ngjashme të vendeve të tjera mund të klikoni këtu.

Gjatë 6 muajve të fundit dhjetor 2018 - maj 2019, “Buletini Mujor Klimatik” ka shënuar mbi 18 mijë klikime në Web site-n e institucionit tonë, gjë që dukshëm tregon për interesimin e përdoruesve për këtë produkt, që jep informacione shkencore mbi vlerësimin e kësaj pasurie kombëtare, siç është klima e vendit tonë dhe ecuria e saj muaj pas muaji.

“Buletini Mujor Klimatik” është i regjistruar dhe në sistemin:

DOI - Digital Object Identifier System



Sistemi “DOI” ka për qëllim regjistrimin e produkteve sipas kategorive të caktuara, artikuj, revista shkencore, etj., me qëllim që një lexues apo studiues të ketë më të lehtë për të gjetur një publikim me një interes të caktuar profesional, natyrisht referuar fjalëve kyçe që përdoren në këto raste.

Në këtë kontekst dhe “Buletini Mujor Klimatik” është regjistruar dhe do të vijojë të regjistrohet periodikisht në këtë sistem me qëllim që të jetë i mundshëm aksesimi për përdorim për një rreth sa më të gjerë të interesuarish për fushën e klimës dhe impaktit të pritshëm nga ndryshimet e saj në vendin tonë.

Në vijim po japim treguesit e DOI-it për Buletinet Mujore Klimatike Nr. 27 dhe Nr. 28 – 2019, të mundësuar nga ato platforma arkivash dixhitale “on line” që ofrojnë këtë tip shërbimi për të ofruar treguesin përkatës DOI për produktin që regjistron siç janë: “Research Gate” dhe “Figshare”, me të cilat është kontaktuar paraprakisht edhe për bashkëpunimin e mëtejshëm.

“Buletini Mujor Klimatik” Nr.27 - 2019

DOI: 10.13140/RG.2.2.10843.62246




“Buletini Mujor Klimatik” Nr.28 - 2019

DOI: 10.6084/m9.figshare.8229269

P Ë R M B A J T J A / C O N T E N T S

<i>Në gjuhën shqipe</i>	<i>In English language</i>	<i>F/P</i>
▪ Situata sinoptike e muajit Maj 2019. ▪ Karakteristikat meteorologjike të muajit krahasuar dhe me vlerat për periudha të ndryshme shumëvjeçare. - Temperaturat e ajrit. ○ Temperaturat mesatare, maksimale dhe minimale të ajrit. ○ Ecuria ditore e vlerave të temperaturave minimale e maksimale për disa vendmatje meteorologjike. ○ Anomalitë e temperaturave kundrejt normës klimatologjike (1961÷1990). ○ Situata e temperaturave në shkallë kontinentale dhe krahasimi me vlerat e periudhës (1981÷2010). ▪ Reshjet atmosferike dhe treguesit përkatës krahasuar me periudhat të ndryshme shumëvjeçare. ○ Vlerat mujore të reshjeve si dhe krahasimi me vlerat e normës. ○ Numri i ditëve me reshje mbi një prag të caktuar. ○ Vlerat maksimale 24 orëshe të reshjeve për muajin maj 2019. ○ Ndryshimet klimatike dhe klima urbane. ▪ Stuhitë gjatë muajit maj 2019. ▪ Parashikimi i vlerave të pritshme për temperaturat dhe reshjet për muajt në vijim, në shkallë rajonale. ▪ Informacione.	▪ Synoptic situation of May 2019. ▪ Meteorological characteristic of the month compared as well as with multiannual period values. - Air temperatures. ○ Mean, maximal and minimal air temperatures. ○ The daily ongoing of minimal and maximal temperatures for some meteorological stations. ○ The anomaly values of temperatures compare to climate norm (1961÷1990). ○ The temperature situation in continental scale and comparison with the period (1981÷2010). ▪ Atmospheric precipitation and the respective indexes compared with different multiannual periods. ○ Monthly value of precipitation compared with norm values. ○ The number of days with precipitation values over a certain threshold. ○ Maximal 24 hours values of precipitation for May 2019. ○ Climate change and urban climate. ▪ Storms during the month of May 2019. ▪ The forecast of temperatures and precipitation values for the next coming months in regional scale. ▪ News.	3 6 6 8 10 10 12 13 13 15 16 17 19



Situata e njollave diellore më datë 31 maj 2019 si dhe një paraqitje grafike e Ciklit të 24 të Njollave Diellore me pozicionimin ku ndodhemi tani.

The Solar Sunspot situation on 31 May 2019, as well as a graphical representation of the 24th Sunspot Cycle with the position we are now in.

Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.

To read the other bulletins you are welcome to visit the respective web site, by clicking on the link of IGEWE.



<http://www.geo.edu.al>



Scientific & Editorial Board:

Prof.Dr. Petrit ZORBA - Head of the Department of Climate and Environment UPT – IGEWE

Prof.Dr. Sylë TAHIRSYLAJ - University of Prishtina – Republic of Kosova.

Dr. Albana HASIMI - Member of the Department of Climate and Environment UPT – IGEWE

Subject Editors (Co-Editors):

Prof. Assoc. Oltion MARKO - Head of Environmental Engineering Department, Faculty of Civil Engineering, Polytechnic University of Tirana, Albania.

External Reviewers:

Dr. José A. GUIJARRO - AEMET – Madrid, Spain.

Editorial Board approved by the Director of IGEWE – Prof.Assoc.Dr. Fatos HOXHAI

Ky buletín u realizua me kontributin e punonjësve të Departamentit të Klimës & Mjedisit të IGJEUM sipas rubrikave si vijon:

This bulletin has been realized by the staff contribution of the Department of Climate & Environment by rubrics as follow:

Data digitalization: Dr. A. Hasimi, Dr. E. Çomo, Dr. A. Bardhi, Ing. A. Gjoni & students: E. Hoxha of UPT of S. Mahmuti of UT.

Data control, verification and elaboration by appropriate software: Prof. P. Zorba, Msc. A. Gjoni.

Evaluation of monthly synoptic situation: M.Sc. M. Marku.

Evaluation of monthly meteorological characteristics and climate change: Prof. P. Zorba.

Storm analysis: Prepared by Dr. E. Çomo.

Medium & long-term weather forecast: Prepared by Dr. A. Hasimi.

Information / News: Prepared by Prof. P. Zorba.



“Buletini Mujor Klimatik”
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit
IGJEUM-UPT.
Tiranë © 2019.



Please consider the environment before printing this bulletin.